



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 shtator 2017  
Nr.ref.: RK 1123/17

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KI123/16**

Parashtrues

**Vullnet Berisha**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN.  
nr. 23/16, të 18 janarit 2016**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

## **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Vullnet Berisha (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i burgosur në burgun e Dubravës dhe i përfaqësuar nga babai i tij Daut Berisha nga fshati Llukarë, komuna e Prishtinës.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin Gjykatës së Apelit, PN. nr. 23/16, të 18 janarit 2016 në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 342/2012, të 17 dhjetorit 2012.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me pretendimin se janë cenuar të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).
4. Parashtruesi i kërkesës pohon se kërkesa e tij duhet të shqyrtohet në pajtim me nenin 50 [Kthimi në gjendjen e mëparshme] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke iu referuar mundësive të tij të kufizuara për shkak të vuajtjes së dënimit me burg, për t'u informuar me kohë për afatin e dorëzimit të kërkesës së tij.

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 47 dhe 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 24 tetor 2016, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 14 nëntor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues, Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
8. Më 15 shkurt 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës së Apelit.
9. Më 5 maj 2016, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë që të dorëzoi në Gjykatë dëshminë (fletëkthesën), që vërteton datën e pranimit të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit (PN. nr. 23/16, i 18 janarit 2016) nga parashtruesi i kërkesës.

10. Më 16 maj 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi dëshminë (fletëkthesën), që vërteton se aktvendimi i lartpërmendur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 26 janar 2016.
11. Më 3 korrik 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

12. Më 10 maj 2012, Prokurori Publik në Prishtinë, me aktakuzën PP. nr. 267-10/2012 dhe PPM. nr. 27-5/2012 kishte akuzuar parashtruesin e kërkesës në bashkëkryerje me të miturin B. Q, për kryerjen e veprave penale vjedhje grabitqare apo grabitje nga neni 256, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK) dhe mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, paragrafi 2 i KPK-së.
13. Më 17 dhjetor 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin P. nr. 342/2012, shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për shkak të veprave penale vjedhje grabitqare apo grabitje dhe mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve të sanksionuara nga dispozitat përkatëse të KPK-së. Parashtruesit të kërkesës iu shqiptua dënimi prej 5 (pesë) vjet burgim dhe dënimi me gjobë në shumë prej 1000 €.
14. Më 18 mars 2013, parashtruesi i kërkesës kontestoi aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës së Qarkut në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.
15. Më 22 korrik 2014, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PAKR. nr. 419/13, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës përkitazi me veprën penale të vjedhjes grabitqare, derisa ndryshoi aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Qarkut dhe refuzoi si të pabazuar akuzën për veprën penale mbajtje në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, ngase kjo vepër penale ishte përfshirë në Ligjin për Amnisti të Republikës së Kosovës.
16. Më 10 nëntor 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë të Gjykatës Supreme, duke pretenduar shkelje të procedurës penale, zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe duke propozuar që atij t'i shqiptohet një dënim dukshëm më i butë ose që aktgjykimet e kontestuara të kthehen për rigjykim.
17. Më 26 mars 2015, Gjykata Supreme me Aktgjykimin PML. nr. 15/2015, refuzoi të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vërtetoi aktgjykimet e kontestuara të gjykatave të instancës më të ulët.

18. Më 17 shtator 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për rishikim të procedurës penale në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke pretenduar se vendimet e gjykatave ishin mbështetur në prova të papranueshme, identifikim jologjor dhe deklarim të rremë të dëshmitarit B. Q., ngase identifikimi ishte bazuar në një përshkrim shumë rrethanor.
19. Më 16 dhjetor 2015, Gjykata Themelore me Aktvendimin Kp. nr. 601/2015, refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishikimin e procedurës penale. Gjykata Themelore, mes tjerash, arsyetoi se në kërkesën për rishikimin e procedurës penale nuk është ofruar ndonjë fakt apo provë e re që ka qenë e panjohur për gjykatat në kohën e marrjes së vendimeve të kontestuara; dhe e cila, më vete apo së bashku me provat tjera do të dëshmonte pafajësinë e parashtruesit të kërkesës ose ai do të dënohej sipas një dispozite më të butë penale.
20. Më 31 dhjetor 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë ndaj aktvendimit të lartpërmendur në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje të dispozitave të KPP-së dhe të nenit 31 të Kushtetutës, duke propozuar që ankesa e tij të miratohet si e bazuar, dhe që aktvendimi i kontestuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.
21. Më 18 janar 2016, Gjykata e Apelit me Aktvendimin PN. nr. 23/16, refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit e pranoi arsyetimin Gjykatës Themelore se nuk janë plotësuar prezumimet ligjore për rishikim të procedurës penale sepse nuk është provuar se aktgjykimet dënuese ishin mbështetur në dëshmi të rreme të dëshmitarit B. Q, dhe për më tepër, dëshmitari B. Q. nuk ishte shpallur fajtor për shkak të dëshmisë së rreme siç përcaktohet me dispozitat përkatëse të KPP-së.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se janë cenuar të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës. Parashtruesi po ashtu pretendon shkelje të nenit 7 [Detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve] të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me nenin 7 [Qasja në Gjykata] të Ligjit nr. 03/L-199 për gjykatat.
23. Përkitazi me kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme bazuar në nenin 50 të Ligjit, parashtruesi i kërkesës pretendon: *“në bazë të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, neni 50 i këtij Ligji, parashtroj këtë kërkesë për kthimin në gjendje të mëparshme ... kjo për arsye se, të drejtën time nuk kam pasur mundësi ta shfrytëzoj pasi që unë gjendem në vuajte dënimit në burgun e Dubravës, dhe mundësitë për t'u njoftuar me të gjitha ligjet dhe të drejtat e mia janë shumë të limituara e po ashtu nuk kam pasur mundësi që të informohen me kohë për afatin e paraqitjes së kërkesës time pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës”.*
24. Përkitazi me zhvillimin dhe rregullsinë e procesit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës, mes tjerash, pretendon: *“Gjatë këtij procesi gjyqësor, nuk është zbatuar drejt Kodi i Procedurës Penale, nuk janë vlerësuar drejt provat, nuk*

*është vërtetuar alibia ime, nuk janë shqyrtuar me vëmendje deklaratimet e të miturit B. Q. dhe të dëmtuarit E. H, nuk është vlerësuar drejt identifikimi nga i dëmtuari (i cili gjatë gjithë procedurës ka pas parregullsi ka qenë kontradiktor dhe jo i rregullt sipas dispozitave ligjore), janë krijuar prova imagjinare (inekzistente) si për shembull arma e cila është marrë si provë vetëm në bazë të një incizimi që është gjendur në telefonin tim, janë futur në procesverbal dëshmi të pavërteta”.*

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ka regjistruar një bisedë telefonike të zhvilluar ndërmjet tij dhe dëshmitarit B. Q. dhe se atë regjistrim do ta sjellë në formë elektronike CD, si fakt i ri dhe provë, që do ta vërtetonte pafajësinë e tij.
26. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: *“Të shqyrtohet ligjshmëria e aktgjykimit fajësues me numër P. nr. 342/2012 të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të gjitha provat të marra nga policia, Prokuroria dhe Gjykata mbi bazën e të cilave është marrë aktgjykimi fajësues i datës 17.12.2014 i cili është i pabazuar dhe i pa argumentuar në fakte dhe prova, i cili është në kundërshtim me ligjet në fuqi, detyrimin të përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve nga neni 7 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, për shkak të faktit se askush nuk mund të gjykohet dhe të dënohet për vepër penale të cilën nuk e ka kryer siç edhe parashihet në nenin 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës penale të Kosovës, për shkak të faktit se nuk është vërtetuar gjendja e plotë dhe faktike, janë zbuluar fakte të reja të cilat vetë ose së bashku me provat e mëparshme arsyetojnë pafajësinë e personit të dënuar si dhe është marrë aktgjykim në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale, dhe AKTVENDIMI i Gjykatës së Apelit me numër PN.nr.23/16 me të cilin ka refuzuar ankesën si të pa bazuar kundër AKTVENDIMIT të Gjykatës Themelore në Prishtinë për rishikimin e procedurës penale të përfunduar me aktgjykim të formës së prerë”.*

### **Pranueshmëria e kërkesës**

27. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
29. Gjykata i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, që parasheh:

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.*

30. Gjykata, po ashtu, merr parasysh nenin 50 [Kthimi në gjendjen e mëparshme] të Ligjit, që parasheh:

*“Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj”.*

31. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, që specifikon:

(1) *“Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:  
(...)*

*c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi; ose”.*

32. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar që në rastin e tij të zbatohet neni 50 [Kthimi në gjendjen e mëparshme] i Ligjit, sepse: *“... të drejtën time nuk kam pasur mundësi ta shfrytëzoj pasi që unë gjendem në vuajtje të dënimit në burgun e Dubravës dhe mundësitë për t’u njoftuar me të gjitha ligjet dhe të drejtat e mia janë shumë të limituara e po ashtu nuk kam pasur mundësi që të informohen me kohë për afatin e paraqitjes së kërkesës time pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës”.*
33. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës ngre pretendime për parregullsinë e procesit gjyqësor ndaj tij, me ç’rast ai pohon se fajësia e tij ishte bazuar në prova të paargumentuara dhe në dëshminë e rremë të dëshmitarit B. Q.
34. Pa paragjykim ndaj pretendimeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës si dhe ndaj procesit të zhvilluar në gjyqësorin e rregullt, Gjykata konsideron, se para së gjithash, si çështje paraprake duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka arritur që ta arsyetojë zbatimin e nenit 50 të Ligjit për kthim në gjendje të mëparshme; dhe rrjedhimisht, të lirohet nga obligimi për ta dorëzuar kërkesën brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.
35. Në rastin konkret, Gjykata vëren se arsyetimi i parashtruesit të kërkesës për mosdorëzim të kërkesës në Gjykatë në pajtim me afatin ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit është i natyrës subjektive dhe ndërliidhet me pamundësitë e tij për ta njohur ligjin dhe të drejtat e tij. Megjithatë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë provë që do të dokumentonte se për shkak të rrethanave objektive, që janë jashtë kontrollit të tij, nuk ka arritur që ta dorëzojë kërkesën brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor.

36. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se, vuajtja e dënimit me burg në vetvete, nuk përbën shkak për lirim nga obligimi për ta dorëzuar kërkesën brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor; dhe për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë provë se ai është penguar nga autoritetet e burgut që ta dorëzoj kërkesën e tij në pajtim me nenin 49 të Ligjit.
37. Gjykata po ashtu konsideron se Ligji për Gjykatën Kushtetuese i plotëson kushtet e parashikueshmërisë, dhe është i qasshëm për shkak se është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe se në përgjithësi, është i qasshëm edhe në mënyrë elektronike në internet.
38. Parashtruesi i kërkesës nuk mund të arsyetohet se mosnjohja e ligjit mund t'i shërbejë atij si bazë për t'u liruar nga obligimi për ta dorëzuar kërkesën brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor sepse ai ka pasur mundësi që kërkesën, nëse ka nevojë edhe me këshillë të duhur juridike, ta dorëzojë brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor. (Për shtjellim të mëtejme të parimit se mosnjohja e ligjit nuk i liron parashtruesit nga përgjegjësia, shih për shembull, *mutatis mutandis*, Rastin *Cantoni kundër Francës*, [DHM], aplikacioni nr. 17862/91, Aktgjykim i 11 nëntorit 1996, §§ 35).
39. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri ligjore, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme, dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (Shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005, dhe *mutatis mutandis*, shih rastin nr. KI140/13, parashtrues *Ramadan Cakiqi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 3 marsit 2014).
40. Gjykata vëren se është detyrë e parashtruesve të kërkesës apo përfaqësuesve të tyre që të veprojnë me *'kujdes të nevojshëm'* (*due diligence*) për t'u siguruar se kërkesat e tyre për mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore janë dorëzuar brenda afatit ligjor katër (4) mujor, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe të specifikuar më tej me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës. (Shih, për shembull, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: rasti. nr. KI07/15, Aktvendim për papranueshmëri i 8 dhjetorit 2016, §§ 52 si dhe referencat tjera të përmendura në atë vendim).
41. Nga shtjellimi i gjertanishëm, Gjykata konsideron se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për kthim në gjendje të mëparshme, siç është përcaktuar në nenin 50 të Ligjit, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur ta arsyetojë kërkesën e tij dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se si dhe pse pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrtojë kërkesën brenda afatit ligjor 4 (katër) mujor. (Shih, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: Rasti nr. KI25/15, Aktvendim për papranueshmëri i 2 dhjetorit 2015, §§ 29).
42. Për më tepër, nga dokumentet e dorëzuara, Gjykata vëren se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit (PN. nr. 23/16 i 18 janarit 2016) i është dorëzuar

parashtruesit të kërkesës më 26 janar 2016; derisa, kërkesa është dorëzuar në Gjykatë më 24 tetor 2016.

43. Sa më sipër, kërkesa nuk është dorëzuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.
44. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e paafatshme dhe duhet të deklarohet e papranueshme, për shkak se nuk është dorëzuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 3 korrik 2017, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Altay Suroy



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Arta Rama-Hajrizi